



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2022:113984
Datë: 27.12.2024
Numri i dokumentit: 06663420

K.DH.SH.II.nr.256/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Eko Term” shpk, me NUI 81135121, me seli ne Suharekë rr. “Brigada 123”, kundër debitorit Komuna e Malishevës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhoma e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1652/22 dt.27.11.2023, me datën 27.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Malishevës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhoma e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1652/22 dt.27.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1652/22 dt.27.11.2023, ka refuzuar ne tërësi si te pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Malishevës, ndërsa ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.269/2022 dt.11.05.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prizren.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës kontestimore neni 181, vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe Gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar dhe çështjen konkrete ta konsideroj si te përfunduar ndërsa urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Eko Term” shpk, me NUI 81135121, me seli ne Suharekë rr. “Brigada 123”, më datën 11.05.2022, ka paraqitur propozim për përmbaerim ndaj debitorit Komuna e Malishevës, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.09/21-KK dt.24.12.2021 dhe nr.10/21-KK dt.24.12.2021. Përmbaeruesi Privat Rushit Hoxha Prizren, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbaerimor P.nr.269/2022 dt.11.05.2022, ka lejuar përmbaerimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga faturat t’i paguaj shumën prej 5,796.90 euro, ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit te këtij urdhri si edhe shpenzimet e procedurës se përmbaerimit.

Kundër urdhrin përmbaerimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 25.05.2022 duke e kundërshtuar urdhrin për përmbaerim me arsyetimin se Komuna e Malishevës nuk ka mund ta ekzekutoj këtë shume te borxhit me kohë, por te njëjtat i ka ekzekutuar ne llogari te kreditorit Eko Term me dat.18.05.2022 sipas faturave qe ka qene obligim i këtij operatori ekonomik, si provë sjell urdhrin e pagesës se lejuar nga Ministria e Punës Financave dhe Transferëve dt. 18.05.2022. Meqë komuna ka kryer obligimet nga përmbaeruesi privat kërkojmë qe te anulohet urdhri përmbaerimor dhe prapësimi i debitori te aprovohet pasi ky borxh nuk ekziston.

Përgjigje ndaj prapësimit te debitorit ka ushtruar kreditori me datën 31.05.2022 duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit ne prapësim si te pabazuara, sepse prova qe i ka bashkangjitur debitori ka te beje me një kërkesë tjetër qe i është bere Ministrisë se Financave për një zotim te mjeteve e qe ky zotim ka ndodhur ne kohen kur janë kryer punimet nga kreditori por asnjëherë deri me sot nuk është kryer obligimi i debitorit ndaj kreditorit. Kreditori nuk ka pranuar asnjë pagesë nga debitori dhe këtë e dëshmojë përmes pasqyrës bankare dt.18.05.2022. Prapësimi i debitorit nuk plotëson asnjë nga kriteret e kërkuara nga neni 71 i LPP, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbaerimor ta le ne fuqi ndërsa ta obligoj debitorin te paguaj shpenzimet për përpilim te përgjigjes ne prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1652/22 dt.27.11.2023, me të cilin e ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka arsyetuar se faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbaerimi janë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë te gjitha elementet e kërkuara ne përputhje me nenin 29 dhe 37 te LPP dhe ne bazë te tyre mund te caktohet përmbaerimi. Këto fatura kanë tiparet e dokumentit te besueshëm sepse përmbajnë te gjitha te dhënat e kërkuara me ligj, janë pranuar nga debitori ne mënyrë te rregullt, kanë vulën e protokollit te Komunës e Malisheve nr.03/2026 dt.24.12.2021 dhe 03/2028 dt.24.12.2021 dhe se nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori ndërsa propozimit për përmbaerim i janë bashkangjitur ne origjinal. Gjykata ka analizuar edhe pretendimet e debitorit ne prapësim por ka vlerësuar se te njëjtat nuk ishin relevante ne

këtë çështje përbarimore, andaj duke vlerësuar se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore për anulim të urdhrit nga neni 71 i LPP vendosi si në dispozitiv të vendimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturave nr.09/21-KK dt.24.12.2021 dhe nr.10/21-KK dt.24.12.2021 të lëshuara nga kreditori e të cilat propozimit për përbarim i janë bashkangjitur në origjinal, pra në pajtim me nenin 37 të LPP i cili parasheh që *“kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Këto fatura janë të vullosura me vulë të protokollit ashtu që fatura 09/21-KK ka vulën e prot. nr.03/2026 dt.24.12.2021 ndërsa fatura me nr. 10/21-KK ka vulën e prot. nr.03/2028 dt.24.12.2021, nga organi kompetent i debitorit Komuna e Malishevës si Institucion Publik, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e një dokumenti, se të njëjtat janë pranuar në mënyrë të rregullt dhe kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 të LPP-së ashtu që si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përbarimit, sepse i përmbajnë elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili thotë se: *“Dokumentit i besueshëm është i përshatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Edhe Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet ankimore të debitorit se i kanë shlyer detyrimet ndaj kreditorit me urdhërpagesën e datës 27.05.2022 mirëpo kjo gjykate në baze të shkresave në lëndë nuk ka mundur të konstatojë se debitori ka përmbushur detyrimet ndaj kreditorit dhe se pagesa të cilës i referohet debitori është Kërkesë zotimi i mjeteve e aprovuar dhe assesi nuk mund të konsiderohet si urdhër pagesë ose transfer bankar, andaj këto pretendime gjykata e shkallës së dytë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përbarimore mbi bazën e parimit të rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban

aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.256/24, me datë 27.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova